

KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date 04.12.2018 (dymije e tetembehjete), u redaktua kontrata e shitjes se kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise MUSA ALBANIA SHPK person juridik shqiptar rregjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NUIS :L81821024M u paraqiten personat e identifikuar si ne vijim:



SHITESI kuotave:

- **BLG shpk**, me seli ne Rr. Tercilio Kardinali, Njesia nr. 11, ndertesa 10, kati 2, shkalla 1, ap. 2, me NIPT L71603025P, e perfaqesuar nga perfaqesuesi i saj ligjor, **Z. Massimiliano Nicolini**, shtetas italian, i datelindjes 16.11.1976, lindur ne Brescia (Itali) me banim ne Tirane, madhor me zotësi te plote juridike,dhe për të vepruar, i pajisur me pasaporte nr. YA 1831944, e vlefshme deri me 01.03.2021, ne cilesine e ortakut te shoqerise Musa Albania shpk , i cilesuar ne vijim si “**Shitesi**”;

BLERESI kuotave:

- **MICROTUNNELING ALBANIA Sh.p.k**, e regjistruar si person juridik si një Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar,me seli ne TIRANE Rruga Marko Bocari, Pallati Pinari II, Dyqani nr.3 me nipt: **L51906030E** e përfaqësuar nga administrator **Z.Mario Serpelloni** lindur me date 06/10/1957 ne Villafranca di Verona(VR), Itali, rezident ne Villafranca di Verona(VR), madhor me zotësi te plote juridike dhe për të vepruar, identifikimi i tij: Nr. i pasaportes/Leter njoftimit: A3858020, e vlefshme deri me date 06/10/2024 i cilesuar ne vijim si “**Bleresi**”

Palët si me sipër me vullnetin e tyre te lire vendosin si vijon:



Neni 1 Objekti kontratës

Ortaku themelues shoqëria BLG sh.p.k vendos ti shesë 1 kuote e cila perben 5% te kapitalit te shoqërisë me vlere 1.300.000 leke qe zotëron ne Shoqërine Musa Albania Sh.p.k , Blerësve si ne vijim:

- Shoqëria **MICROTUNNELING ALBANIA Sh.p.k** , I cili pranon te bleje kuotat qe shitesi zoteron ne Shoqërine Musa Albania sh.p.k.

Neni 2 Çmimi dhe pagesa

2.1 Çmimi i caktuar për shitjen e kuotave te shoqërisë është vlerësuar ne baze te vleres se kapitalit themelor, i cili eshte 26.000.000 leke, si pasoje shitesi shet kuotat blerësve si vijon:

- Shoqëria **Shoqëria MICROTUNNELING ALBANIA Sh.p.k** , i blen kuotat ne masën 5% te kapitalit me vlere 1.300.000 leke.

Palët deklarojnë qe çmimi do te shlyhet me trasferte bankare brenda 5 dite pune nga nenshkrimi i kesaj kontrate.

2.1 Sipas nenit 33 te ligjit nr. 8438 te datës 28.12.1998, i modifikuar, palët caktojnë me marrëveshje dhe pranojnë qe Shitesi do te derdhe për llogari te tatimeve, ne baze te parashikimeve ligjore përkatëse, 15 % te tatim fitimit nga çmimi i shitjes se kuotave.

Neni 3 Pronësia dhe transferimi i kuotave

3.1 Pala shitëse i garanton palës blerëse se kuotat janë te lira nga çdo detyrim ligjor dhe financiar ndaj te treteve dhe për çdo pretendim qe mund te ngrëne te tretet ajo është e gatshme dhe e detyruar te paraqitet me kërkesën e palëve blerëse para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për te mbrojtur te drejtën e tij si pronar i ligjshëm i këtyre kuotave.

3.2 Pronësia e kuotave i transferohet blerësve ne momentin e nënshkrimit te kësaj kontrate shitblerje.

Sa parashikuar ne dispozitat kontraktuese te mësipërme, ne përputhje me nenin 686 te Kodit Civil Shqiptar, Blerësit deklarojnë se pranojnë dhe miratojnë veçmas Nenin 2 (**Çmimi dhe pagesa**).

Me nenshkrimin e kesaj kontrate , shitesit , shoqeria BLG sh.p.k ortak themelues i shoqerise Musa Albania Sh.p.k zhvishet nga pronesia e 1 koute me perqindje 5% te kapitalit themeltar dhe bleresi **MICROTUNNELING ALBANIA Sh.p.k** behet zoterues i nje kuote me perqindje 5% te kapitalit fillestar.

PALET KONTRAKTUESE

PALA SHITESE

BLG SHPK

Z. Massimiliano Nicolini



PALA BLERESE

MICROTUNNELING ALBANIA Sh.p.k

Z.Mario Serpelloni

SERPPELLONI MARIO

